



VENDIM

Nr.48 Datë 17.04.2015

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PER LICENSIMIN E SHOQERISE
“MESOPOTAM ENERGJI” SH.P.K., NE AKTIVITETIN E
TREGETIMIT TE ENERGJISE ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 gërma “a”;nenit 9 dhe nenit 13 pika 1, gërma “d”, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “g”; neni 8 dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 17.04.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “**MESOPOTAM ENERGJI**” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

Konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë “Mesopotam Energji” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

Neni 9, pika 1, Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 2 Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 3 Dokumentacioni financiar dhe fiskal është plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 4/10, germa “a” Sasia e energjise elektrike e parashikuar per tu tregtuar. E paplotesuar.

Neni 9, pika 4/10, germa c, plotesuar

Per dokumentacionet e munguara, do te njoftohet subjekti qe ne baze te “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit te Plote/te Pjesshem dhe Rinovimit te Licensave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, ti paraqese keto ne ERE, brenda afateve.

Neni 9, pika 4.1.5 *Leje nga institucione të tjera.*

Eshte plotesuar teresisht.

Eshte ne proces miratimi i pikes se lidhjes me sistemin.

Per dokumentacionet e munguara, do te njoftohet subjekti qe ne baze te “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit te Plote/te Pjesshem dhe Rinovimit te Licensave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, ti paraqese keto ne ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave per licensimin e shoqerise “MESOPOTAM ENERGJI” sh.p.k., ne aktivitetin e tregetit te energjise elektrike.
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionerëve te ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE-s

Petrit AHMETI